



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr.210/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Kunushevcu kryesues, Kymete Kicaj dhe Afiete Sada – Glligjani anëtare, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Lutfie M. Ajvazi, duke vendosur përkitazi me ankesat e Organizatës Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër koalicionit AAK-PSD, me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 05.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

PRANOHET e bazuara ankesat A.nr.210/2019 e datës 03.10.2019, e paraqitur nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, kundër koalicionit AAK-PSD, me seli në Prishtinë, për shkak se me datën 03.10.2019, në profilin e tij facebook kandidati për deputet Blerim Kuçi ka shpërndarë një video spot, në të cilën ka shfaqur pamje të pjesëtareve të uniformuar të Forcave të Sigurisë së Kosovës (FSK), dhe me rastin e publikimit të këtij video spoti i njëjti ka shkruar “100% fitore për 100% Shtet”, që paraqet shkelje, të nenit 35 par.1, të LZP-së, koalicionit AAK-PSD, me seli në Prishtinë, i **SHQIPOHET** gjobë në lartësi prej 9,800.00 (nëntëmijë e tetëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga plotfuqishmëria e këtij vendimi, nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

PZAP-i, më datë 03.10.2019, ka pranuar ankesën A.nr.210/2019, nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër koalicionit AAK-PSD, me seli në Prishtinë, e cila pretendon se kandidati për deputet, Blerim Kuçi nga radhët e koalicionit AAK-PSD, më datë 03.10.2019, përmes llogarisë së tij facebook, ka shpërndarë një video spot, në të cilën ka shfaqur pamje të pjesëtareve të uniformuar të Forcave të Sigurisë së Kosovës (FSK), dhe me rastin e publikimit të këtij video spoti i njëjti ka shkruar “100% fitore për 100% Shtet”, veprim ky i cili përbën shkelje të nenin 1 pika 5.2 e Riformuluar pika b), të Rregullës Zgjedhore nr.20/2019 mbi ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Zgjedhore nr.13/2013. Paraqitësi i ankesës, si dëshmi për pretendimet e tyre, ka bashkangjitur një fotografi dhe një CD, si provë materiale.

Në përgjigjen në ankesë të datës 04.10.2019, subjekti politik koalicioni AAK-PSD, thekson se publikimi i video spotit në rrjetin social facebook, të kandidatit për deputet Blerim Kuçi, ku shihen pjesëtarët e uniformuar të FSK-së, nuk përbën shkelje sepse i njëjti nuk ka

shfrytëzuar pjesëtarët e uniformuar të FSK-së, por vetëm ka postuar xhirime të FSK-së, që janë incizuar nga Televizione të ndryshme në periudha të ndryshme kohore, dhe sipas subjektit politik në fjalë, sikur të kishte pasur ndonjë pjesëtarë të FSK-së në uniform duke proklamuar kandidatin për deputet Blerim Kuçi, do të përbënte shkelje. Koalicioni AAK-PSD, përgjigjes në ankesë, si provë i ka bashkangjitur fotografi nga publikimi në media i thirrjes së subjektit politik koalicionit AAK-PSD, për respektimin rigoroz të rregullave zgjedhore.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 paragraf 2, të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

PZAP në bazë të dëshmive të ofruara si provë materiale, një fotografi dhe CD, ka vlerësuar se subjekti politik koalicioni AAK-PSD, ka bërë shkelje të Kodit të Mirësjelljes, nga fakti se, kandidati për deputet Blerim Kuçi, nga radhët e koalicionit AAK-PSD, ka shpërndarë një video spot në llogarinë e tij facebook, në të cilën ka shfaqur pamje të pjesëtarëve të uniformuar të FSK-së, dhe me rastin e publikimit të këtij video spoti ka shkruar “100% fitore për 100% Shtet”, i cili paraqet veprim në kundërshtim dhe paraqet shkelje nga neni 35 par. 1 dhe 2, të Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme, si dhe nenit 1 pika 5.2 e Reformuar pika b), të Rregullës Zgjedhore nr. 20/2019 mbi ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores Zgjedhore nr.13/2013 të KQZ-së, ku parashihet se: “*Në fushatën e zgjedhjeve të asnjë subjekti politik të certifikuar nuk mund të përfshihen kategorit; b) pjesëtarët Forcave të Sigurisë së Kosovës*”.

Paneli me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë; si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret, se ky subjektet politik koalicioni AAK-PSD, ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara, që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe përkundër këtij fakti gjatë fushatës zgjedhore, në video spotin e tyre zgjedhor kanë përfshirë pjesëtarë të uniformuar të FSK-së, veprim ky i sanksionuar me dispozitat e lartcekura të rregullave zgjedhore.

Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që koalicionit në fjalë, i'u dha mundësia për tu përgjigjur në ankesë dhe ta përmirësojë shkeljen e bërë, mirëpo subjekti politik nuk e ka pranuar shkeljen e bërë, ku sipas tyre kjo nuk përbën shkelje, dhe si dëshmi ka ofruar vetëm një fotografi me thirrjen për respektimin e kodit zgjedhor, veprim ky i cili ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar, në kuptim të nenit 35 paragrafi 2, nenit 120 paragrafi 1 pika c)


të LZP-së dhe nenit 5 paragrafi 2 i Rregullës Nr. 01/2012, Për Kategorizimin e Sanksioneve dhe Gjobave të PZAP-it.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 118 par.1 dhe nenit 120 par.1 pika c) të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.210/2019 më datë 05.10.2019

Kryesues i Panelit
Adnan Konushevc



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.